

PKR.nr.88/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Suzana Çerkini kryetare, Arben Hoti dhe Nora Bllaca-Dula anëtarë, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.M nga P, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK, i akuzuar me Aktakuzë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.240-2/2007 të datës 21.02.2014, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 25.01.2017, me praninë e Prokurorit të shtetit Besa Limani, të akuzuarit A.M, me mbrojtësin sipas autorizimit av.Sh.B, me datë 27.01.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.M, nga i ati S dhenëna N, e vajzërisë Rr, i lindur më *data e lindjes* në P, ku edhe jeton, me vendbanim në lagjen e S, rruga "...", kompleksi "P"Hyryja., kati ., nr..., ka të kryer shkollën tetë vjeçare dhe dy vjet të shkollës së mesme, punon në pompën e benzimës "I P" nëPrishtinë, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim të RKS me nr.personal *numer personal*,

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar. 1.3 të KPP,

LIROHET NGA AKTAKUZA

Sepse, me datë 08.03.2007, rreth orës 15:55 në Prishtinë, në rrugën "Isa Kastrati, derisa i dëmtuari A.H me veturën e tipit "P", me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit *targa te regjistrimit*, duke hyrë në oborrin të shtëpisë së tij, kishte dalë nga vetura për t'i hapur dyert e oborrit, i pandehuri A.M e kishte fyer të dëmtuarin A.H, duke e sharë me antarë të familjes, duke e kërcënuar me fjalët "ka me iu kallë krejtëve", e kishte goditur me guri veturën e të dëmtuarit dhe e kishte ekspozuar revolen me ngjyrë të zezë, ashtu që e ka vendosur dorën në revole, në brez, ka tentuar t'a nxjerrë revolen me qëllim t'a kërcënojë dhe frikësojë të dëmtuarin A.H, e më pas i pandehuri A.M ka hyrë në oborrin e shtëpisë së vet,

- Pasi që nuk është provuar se ka kryer veprë penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK,
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës,
- Kërkesë pasurore juridike nuk ka patur,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda me Aktkuzën PP.nr.240-2/2007 të datës 21.02.2014, ka akuzuar A.M për veprën penale Mbajtja në pronësi, posedim, kontroll apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të njëjtit t'a shapall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar mbajti shqyrtimi gjyqësor, në të cilin prezantuan prokurori i shtetit dhe i akuzuari A.M i shoqëruar me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare, av. Sh.B. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare, mbeti pranë aktakuzës, ndërsa i akuzuari nga fillimi e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka mohuar fajsinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj gjykata ka vazhduar procedimin e çështjes me administrimin e provave.

Gjykata, pas administrimit të tërësishëm të provave në shqyrtim gjyqësor dhe dëgjimit të t'akuzuarit A.M, bëri vlerësimin e tyre një nga një dhe të ndërlidhura reciprokisht njërën me tjetrën dhe vërtetoi se mungojnë provat me të cilat do të vërtetohet fajsia e të akuzuarit A.M, andaj të njëjtin e liroi nga akuza.

Gjykata, faktin pse i akuzuari A.M duhet liruar nga akuza në mungesë të provave, e vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarit –dëshmitarit A.H, e dëshmitarit të propozuar nga mbrojtja V.M, si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit A.M.

Në cilësi të dëmtuarit, dëshmitari A.M deklaroi se nuk dëshiron të parashtojë kërkesë pasurore-juridike, ndërsa në cilësi të dëshmitarit, i njëjti deklaroi se me të A janë fqinjë qe 30 vjet, ndërsa me datë 08.03.2007 kishte marrë pjesë si publik në gjykimin e vëllaut të t'akuzuarit A.M, Shqiptar M dhe, ishte kthyer në shtëpi rreth orës 14:00, kishte dalë me veturë dhe rreth orës 15:55, ishte kthyer prap në shtëpi, i ka hapur dyert e oborrit dhe duke hyrë me lëvizje prapa me veturë në oborrin e shtëpisë së vet, ndërsa A nga dera e shtëpisë së vet kishte fillu me e sha me fjalë të rënda “ta q...nanën, kam me ju kall krejtëve” andaj edhe është ndier i frikësuar, A e kishte gjuajtur njëherë me guri, e kishte dëgjuar krismën e gurit në anën e poshtme të derës së djathtë, por kur ka dalë nga vetura e ka parë shenjën e gurit në veturë por gurin nuk e ka parë. Në vazhdim thekson se derisa ishte ende në veturë me dritare të mbyllura, në largësi prej 12-13 metrash, pa ndonjë pengesë fizike ndërmejt tij dhe A, duke shiqur nga dritarja e anës së djathtë të veturës, e kishte parë A duke e vendosur dorën në brez, duke e kap kondakun e armës ngjyrë të zezë, armën në tërësi nuk ia kishte parë por vetëm kondakun, për këtë është i sigurt, në ato momente derisa A ka tentu me nxjerrë revolen, ka dalë vëllau i tij V, ka ndërhy, e ka kap A për dore dhe e ka fut brenda derës së shtëpisë, nuk ka vërejtë rezistim nga ana e A dhe, në fund thekson se nga atëherë nuk kanë pasur më asnjë problem mes veti e as me familje, derisa sqaron se vëllau i A atë ditë ishte dënuar për tentim vrasje të babait dhe axhës së të dëmtuarit. Në deklarimin e dhënë në polici, i dëmtuari A ka theksuar se kur ia ka parë kundakun në brez të akuzuarit A1, ky i fundit kishte patur të veshur trenerka.

Dëshmitari V.M, në dëshminë e tij deklaroi se pas gjykimit dhe dënimit të vëllaut të tij Sh.M, të gjithë kishin shkuar në shtëpi dhe kanë qajtur e vajtuar dhe, nuk ka parë të ketë ndodhur diçka midis A1 e A, atë ditë nuk ka parë armë dhe nuk din që A1 ka mbajtur armë.

I akuzuari A.M në mbrojtjen e vet deklaroi se, ditën kritike pas gjykimi të vëllaut të tij Sh, diku në mesditë, pasi ishin larguar A me familjen e vet, me përcjellje të policisë ishin kthyer në shtëpi ku kanë pasur edhe familjarë të tjerë, nëna ka qenë në gjendje të keqe shëndetsore, andaj as ky e as vëllezërit nuk kishin dalë nga shtëpia, pas afër një ore policia i kishin shkuar në shtëpi dhe ia kishin kërkuar armën, njëri nga policët i kishte hyrë për dritare në shtëpi dhe e ka pyetur “ku e ke revolen” e kishin marrë në polici për intervistim, me A dhe familjen e tij atë ditë nuk ishin parë fare deri pas dy-tri ditësh, meqë i kanë afër garazhet për servisim të automjeteve, por secili e punon punën e vet, atë ditë thekson se nuk ka mbajtur fare armë në brez dhe se nuk ka kërcënuar askend. Në fund shton se largësia midis shtëpisë së tij dhe vendit ku pretendon Anse ka qenë me veturë, është dikund 25 metra e jo siç ka thënë A në deklarinimin e tij të dhënë në këtë shqyrtim, 12-13 metra, mirëpo me qëllim që të mos e acarojë situatën nuk kishte reaguar fare pas deklarimit të tij. I akuzuari ka deklaruar edhe në polici me ç’rast ka mohuar të ketë mbajtur armë, të ketë gjuajtur me guri apo të ketë kërcënuar të dëmtuarin A.

Prokurori i shtetit, fjalën përfundimtare e prezantoi në formë të shkruar dhe të njëjtën e elaboroi gojarisht duke theksuar se i akuzuari A1 e kishte goditur me guri në veturë, i dëmtuari A e kishte parë A1 duke e vënë dorën në kondak të armës në brez, ngjyrë të zezë dhe se, kur i njëjti ka tentuar t’a nxjerrë armën, kishte ndërhyrë vëllau i tij V dhe e kishte penguar A1, e kishte kapur për dorë dhe e kishte futur në shtëpi. Kësaj deklarate të t’ dëmtuarit duhet besuar meqë është e njëjtë sikur edhe deklaratat e dhënë në fazat e mëparshme penale, ndërsa deklaratat e të akuzuarit A1 nuk duhet falë besimin, meqë i njëjti tenton t’i ikë përgjegjësisë penale, derisa nga fotodokumentacioni i bashkangjitur shkresave të lëndës shihet edhe dëmtimi i veturës, e që e arsyeton faktin se i akuzuari A.M pas përfundimit të gjykimit të vëllaut të tij, i mllëfosur me epilogun e gjykimit, me dashje direkte e ka gjuajtur me gurë veturën e të dëmtuarit A, e ka sharë me familje e pastaj i është kërcënuar me revole, andaj, propozon që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me ligj.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, në fjalën përfundimtare thekson se i mbrojturi i tij, i akuzuari A.M nuk ka mbajtur armë, përndryshe askush nuk do t’a kishte ndaluar me e nxjerrë armën, ndërsa element i veprës penale nga neni 328 të KPK është mbajtja në pronësi, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armës, përdorimi i armës dhe vringëllimi i saj për qëllim frikësimi apo kërcënimi, andaj për këtë kryesi i kësaj vepre duhet të ketë armë, ndërsa arma nuk ekziston, nuk është gjetur fare nga policia e cila ka vërtetuar se A1 nuk ka prekur armë fare, meqë testi i parafinës ka rezultuar negativ, ndërsa sipas dëshmisë së të dëmtuarit se me të akuzuarin ka qenë në distancë prej 12-13 metra, derisa i njëjti ka qenë në veturë, vetura në oborr, e oborri ka qenë i rrethuar nga ana e rrugës, atëherë si ka mundur t’a shohë me saktësi se A1 ka pasur armë dhe, si ka mundur A1 t’a mbajë revolen në brez nëse i njëjti ka pasur të veshur trenerka, ndërsa sa i përket ngjyrës së zezë të kondakut, i akuzuari vetëm me hamendësim e ka thënë, meqë gati të gjitha armët janë ngjyrë të zezë. Në vazhdim mbrojtësi thekson se fotodokumentacioni nuk tregon asgjë, meqë nuk mund të përcaktohet kur, me çka dhe nga kush është shkaktuar shenja e vogël e dëmtimit në veturë, andaj konkludon se nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, andaj i propozon gjykatës që të akuzuarin t’a lirojë nga aktakuza.

Sipas vlerësimit të gjykatës, përshkrimi i rastit që bënë i dëmtuari-dëshmitari A.H, se të akuzuarit A.M në largësi prej 12-13 metra, ia kishte parë kondakun e armës-revoles ngjyrë të zezë në brez dhe se i njëjti e ka vënë dorën mbi kondak duke tentuar t’a nxjerrë armën, nuk paraqet gjetje të sigurtë të gjykatës se vërtetë i akuzuari ka mbajtur revole në brez, sepse i veshur në trenerka vështirë se ka mund t’i qëndrojë arma në brez pa e mbajtur me dorë, e sikur t’a ketë vënë dorën në brez, vështirë

së ka mund të shihet mjeti apo ngjyra e mjetit nga ajo distancë, kurse dëshmitari V thotë se nuk ka parë fare armë tek A1, nga ana tjetër në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi se revolva i është gjetur të akuzuarit në shtëpi. Gjithashtu edhe pika e shenjzuar në veturën e të dëmtuarit, për gjykatën nuk paraqet gjetje të sigurtë se ajo shenjë është shkaktuar nga goditja me gurë nga ana e të akuzuarit A1, meqë nuk ka konstatim të saktë profesional se kur është shkaktuar ajo shenjë e dëmtimit në veturë, e as kur dhe nga kush është fotografuar vetura. Ndërsa fakti se i akuzuari e ka sharë me fjalë fyese të dëmtuarin nga distanca e cekur, nuk është vërtetuar nga asnjë dëshmitar tjetër, sërish gjykata nuk mund t'a marrë si fakt të vërtetuar, ndërsa i pakontestuar është fakti se pas kësaj ngjarjeje, i akuzuari dhe i dëmtuari, nuk kanë patur asnjë problem. Përfundimisht, pretendimin e prokurorisë se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, duke lënë kështu paqartësi qenësore se a ka ekzistuar arma tek i akuzuari ose familjarët e tij në shtëpinë e tij, gjykata e ka marrë si të paqëndrueshëm, sepse bazuar në parimin e ligjshmërisë, në çdo rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale duhet të interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. Pra, bazuar në provat e administruara, sipas bindjes së gjykatës nuk është vërtetuar se i akuzuari A.M, me datë dhe kohë të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, ka mbajtur armë, poseduar apo vringëlluar armën, me qëllim frikësimi të të dëmtuarit, andaj në mungesë të provave i njëjti është liruar nga akuza.

Gjykata nuk e udhëzoi të dëmtuarin A.H në kontest civilo-juridik, meqë i njëjti shprehimisht ka theksuar se nuk dëshiron të parashtrojë kërkesë pasurore-juridike.

Vendimin mbi lirimimin në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.88/14, me datë 27.01.2017**

**Sekretarja juridike,
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.